



A.nr.508/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.508/2026, të datës 07.05.2026, të parashtruar nga ankuesit F.A, H.G, F.D dhe A.B, të cilët me autorizim i përfaqëson Zyra e Avokatisë *Klinaku & Associates L.L.C*, me seli në Prishtinë kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*Komposime Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.06.2026 mori:

## V E N D I M

**I.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.524/2026, të datës 12.05.2026, të parashtruar nga ankuesve F.A, H.G, F.D dhe A.B.

**II.** Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

## A r s y e t i m

F.A, H.G, F.D dhe A.B, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesit), më datë 04.05.2026 (përmes postes), kanë parashtruar ankesë në KPMSHCK, e pranuar me datë 07.05.2026, dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.508/2026, me pretendimin mbi të drejtën për kompensim të vlerës sipas përvojës së punës nga 0.25% në 0.50%, nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave e në vazhdimësi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesit janë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në atë mënyrë që së ankuesi A.B sipas Akt emërimit me numër 019/2022 të datës 24.06.2022, ka ushtruar pozitën *Zyrtar Korrektues*; ankuesi F.D sipas Akt emërimit me numër 229/2024 të datës 17.07.2024, ushtron pozitën *Zyrtar Korrektues*; ankuesja F.A sipas Akt emërimit me numër 162/2023 të

datës 07.11.2023, ushtron pozitën *Zyrtar Korrektues* dhe ankuesi H.G sipas Akt emërimit me numër 486/2026 të datës 21.01.2026, ushtron pozitën *Mbikëqyrës*.

Tutje, nga provat materiale del se ankuesit me datë 02.04.2026 kanë paraqitur kërkesë për kompozimin e vlerës sipas përvojës se punës nga 0.25% në 0.50% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave e në vazhdimësi

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kërkojnë që Këshilla të aprovoj ankesën si të bazuar, duke detyruar që Shërbimi Korrektues i Kosovës të paguaj në emër të kompensimit për vlerën sipas përvojës se punës nga 0.25% në 0.50% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave dhe tani e tutje nga 0.50%.

Në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për shqyrtim dhe vendosje lidhur me çështjen në procedurë, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 4 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtaret Publik (në fuqi nga data 17.06.2025) e më të cilin parashihet se : **Neni 4:** 4 1. Në paragrafin 2. të nenit 3 të ligjit bazik pas nën-paragrafit 2.9. shtohen nën-paragrafët si në vijim: ...2.18. zyrtarët korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës.. 6.1. Neni 6 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim: **Neni 6:** *Nëpunësi civil me status të veçantë 1. Nëpunësi civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunësit civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarit e Shërbimit Korrektues të Kosovës, **përrjashtimisht zyrtarët korrektues***”, dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor konstatohet se zyrtarët korrektues nuk kanë statusin e nëpunësit civil, rrjedhimisht, të njëjtit janë përjashtuar nga fushëveprimi i Ligjit për Zyrtarët Publik/shërbimit civil.

Në ndërlidhje më konstatimin si më sipër, Kolegji ve në dukje edhe përcaktimet e nenit 3 nënpika 1.17 të Ligjit NR.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas të cilave dispozita Zyrtarë Korrektues konsiderohet personeli i uniformuar dhe i graduar, kurse, sipas nenit 28 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës e përbëjnë: 1.1. nëpunësit civil; 1.2. **zyrtarët korrektues profesional të armatosur në uniformë dhe grada të rregulluara me këtë Ligj**; 1.3. stafi mbështetës përbëhet nga stafi teknik dhe administrativ të cilët kryejnë veprimtari ndihmëse. 2. Personeli i SHKK sipas paragrafit 1. të këtij neni janë nëpunës civil dhe nëpunës të uniformuar të sigurisë, sipas këtij ligji dhe ligjit për zyrtarët publikë. 3. Personeli i Shërbimit Korrektues sipas paragrafit 1. të këtij neni janë nëpunës civil me status të veçantë sipas ligjit për zyrtarët publikë....* si dhe nenit 53 par grafi 1 ku përshihet se: *Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat vijuese: 1.1. kadet për zyrtar korrektues; 1.2. zyrtar korrektues; 1.3. mbikëqyrës; 1.4. mbikëqyrës i Lartë; 1.5. udhëheqës i Njesisë.* Rrjedhimisht, nga ky përcaktim ligjor rrjedhë se si zyrtar të unifomuar korrektues konsiderohen zyrtaret sipas paragrafit 1 të nenit 53 të Ligjit NR.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Andaj, referuar nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, e duke qenë se ankuesit nuk kanë statusin e nëpunësit civilë, rrjedhë se Këshilli nuk ka juridiksion ligjor që të vendos lidhur më çështjen e ankuesve të iniciuar sipas ankesës A.nr.508/2026.

Në kuptim të së drejtës kushtetuese dhe ligjore në mjete juridike, e meqenëse Ligji Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës nuk ka përmbanë dispozitë ligjore lidhur me të drejtën në ankesë të

zyrtarëve korrektues, Kolegji i Këshillit duke iu referua edhe aktit të themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesi erdhi në përfundimin se më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e drejta e ankesës së zyrtarëve korrektues i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, ku shprehimisht thuhet se: **Neni 79, paragrafi 1** “... **1.** I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. **2.** Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. **Neni 79 paragrafi 1:** Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...” Rrjedhimisht, zyrtaret korrektues në SHKK, në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të parashtrojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë materiale për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.508/2026, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet së ankuesit kanë parashtuar ankesë të brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75, paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.508/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së ankuesve Klinaku & Associates L.L.C;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës: Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore,
- Arkivit të KMPSHCK-së